



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21 regjistër (JR)
Datë 26.06.2020

Nr. 2 i vendimit
Datë 13.01.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 13.01.2021, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 249, datë 06.03.2020, i cili i përket subjektit të rivlerësimit Piro Samara, inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në mungesë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 249, datë 06.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur në pjesën urdhëruese të këtij vendimi ndalimin e emërimit në organet e drejtësisë për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimit të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Piro Samara, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ishte në funksionin e inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Procesi i rivlerësimit për subjektin rivlerësimit ka nisur me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimit të nenit 4, pika 3, dhe Komisioni ka vijuar me procedurën administrative ndaj këtij subjekti¹, pasi për të është administruar vendimi nr. {***}, datë 22.10.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), i cili ka vendosur deklarinimin e mospasjes së statusit “magjistrat” për z. Piro Samara.
3. Rezulton se, bazuar në vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, të KLGj-së, kryetarja e këtij organi ka nxjerrë urdhrin nr. {***}, datë 30.10.2019, në të cilin disponon për “Lirimin nga detyra të z. Piro Samara, në detyrën e inspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit dhe kërkesës për dorëheqje.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, bazuar në vendimin e KLGj-së nr. {***}, datë 22.10.2019, dhe në urdhrin nr. {***}, datë 30.10.2019, të kryetares së KLGj-së për subjektin e rivlerësimit Piro Samara, ka arsyetuar se:
 - i. Neni 179/b i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen *ex officio* të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, prokurorët, këshilltarët, kryeinspektorin dhe inspektorët e KLD-së.
 - ii. Neni 64, pika “c” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se një nga arsyet për mbarimin e statusit të gjyqtarit, është mbushja e moshës për pension.
 - iii. Dispozitat kalimtare, neni 160, germa “ë” e ligjit nr. 96/2016 parashikon se një nga kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vërtetimi i ndërprerjes së emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit, ku për analogji si shkak konsiderohet edhe mospasja apo humbja e statusit të magjistratit.
 - iv. Për sa më lart, Komisioni konstaton se nga momenti që z. Piro Samara nuk ka statusin e magjistratit, nuk mund të jetë një nga subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
 - v. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se objekti dhe qëllimi për të cilin synon procedura e rivlerësimit, është bërë i pamundur. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave

¹ Prej Komisionit, kjo çështje është përfshirë në grupin e çështjeve të subjekteve që kanë dhënë dorëheqjen nga funksioni për shqyrtimin e të cilave, me vendimin nr. {***}, datë 26.02.2019, ka përcaktuar trupin gjykues i cili do të ushtronte këto kompetenca për periudhën mars 2019 deri më 8 mars 2020.

Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

5. Bazuar në këtë arsyetim, Komisioni, me vendimin nr. 249, datë 06.03.2020, mbështetur në nenet 14 e 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, ka vendosur:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për z. Piro Samara, me funksion inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk duhet të nisë ose duhet të konsiderohet i pushuar.

III. Shkaqet e ankimit

6. Më datë 09.06.2020, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 249, datë 06.03.2020, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik Darjel Sina, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

6.1 Subjekti i rivlerësimit Piro Samara, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, është subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe, në këto kushte, procesi i rivlerësimit ndaj tij mundej, për shkak të vullnetit të tij, vetëm të pushohej ose të ndërpritej.

6.2 Komisioni nuk ka identifikuar dhe vlerësuar drejt faktet dhe rrethanat ligjore mbi të cilat ka ndërprerë/pushuar procesin e rivlerësimit si edhe, nëse ndodhemi në kushtet e dorëheqjes, Komisioni do të duhej të vlerësonte:

- vullnetin e lirë dhe të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje;
- rrethanat konkrete, nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin;
- caktimin e ndalimit të emërimit për periudhën 15-vjeçare, sipas pikës 2 të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, në dispozitivin e vendimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit

brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit², në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 249, datë 06.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se ai është ushtruar nga Komisioneri Publik, prej Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) kryhet në seancë gjyqësore publike. Seanca gjyqësore publike për gjykimin e kësaj çështjeje u zhvillua në mungesë të subjektit të rivlerësimit, i cili megjithëse ishte njoftuar rregullisht në përputhje me parashikimet e neneve 46 e 65 të ligjit nr. 84/2016 e nenit 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile për ditën dhe orën e gjykimin, nuk u paraqit dhe nuk parashitroi as arsye për mungesën e tij.

B. *Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji*

10. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit Piro Samara, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ishte subjekt rivlerësimit *ex officio* dhe, në këto kushte, procesi i rivlerësimit ndaj tij mundej, për shkak të vullnetit të tij, vetëm të pushohej ose të ndërpritej, Kolegji, pasi analizoi rrethanat faktike në raport me legjislacionin e zbatueshëm, arriti në konkluzionin se është një pretendim i drejtë.

10.1 Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji vlerësoi rrethanat faktike që i përkasin subjektit, nga të cilat rezultoi se në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e inspektorit të KLD-së. Sipas parashikimit të kësaj dispozite, i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio* të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këto kushte, në kuptim të kësaj dispozite, si edhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se subjekt rivlerësimi janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka fituar këtë status ligjor që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese e, për pasojë, do të duhej t’i nënshtrohej *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces.

11. Krahas rrethanave të përshkruara më lart, nga aktet e ndodhura në fashikull, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit Piro Samara ka qenë i emëruar në pozicionin e inspektorit të KLD-së nga kategoria e inspektorëve jomagjistratë, sipas parashikimit të nenit 14, pika 3³ e ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe për shkak të kësaj emërtese KLGj-ja ka verifikuar statusin e tij dhe ka konkluduar me vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, për

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2020, Komisioni u përcollti Komisionerëve Publikë njoftimin e vendimit nr. 249, datë 06.03.2020, për subjektin e rivlerësimit Piro Samara. Ky njoftim është regjistruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 28.05.2020. Ankimi i Komisionerit Publik Darjel Sina është përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 09.06.2020. Me vendimin nr. {***}, datë 10.06.2020, Komisioni vendosi pranimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 249, datë 06.03.2020, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012.

³ Neni 14, pika 3 e ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, parashikonte se:

“3. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet”.

deklarimin e mospasjes së statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, vendim i cili nuk rezulton të jetë ankimuar prej subjektit në Gjykatën Administrative të Apelit.

11.1 Mbështetur mbi këtë disponim të KLGj-së, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk është më i tillë, për sa kohë që ai nuk gëzon statusin e magjistratit dhe se procesi i rivlerësimit për të nuk duhet të nisë ose duhet të pushohet. Kolegji, pasi shqyrtoi këtë qëndrim të Komisionit nën dritën e pretendimeve të Komisionerit Publik të parashtruara në ankim, arrin në konkluzionin se ky qëndrim i Komisionit vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe se ai nuk mund të përdoret si argument për ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Piro Samara.

11.2 Vendimi i KLGj-së i cituar më lart, që deklaroi mospasjen e statusit të magjistratit prej subjektit të rivlerësimit, vlerësohet prej Kolegjit në raport me parashikimin e nenit 179/b të Kushtetutës, i cili i jep inspektorit të KLD-së që gjendet në këtë detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, statusin e subjektit të rivlerësimit, të pakushtëzuar nga pasja ose jo e statusit të magjistratit, por për shkak të funksionit që ushtron në këtë moment të veprimit të këtij parashikimi kushtetues. Ky lexim i dispozitës kushtetuese është në të njëjtën linjë i zbërthyer në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), të cilët potencojnë në detaje dhe në mënyrë të shprehur jo vetëm faktin se ligjvënësi ka parashikuar ruajtjen e statusit si subjekt rivlerësimi të fituar nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese edhe për subjektet jomagjistratë, por ka rregulluar edhe kriteret dhe modalitetet mbi të cilat procesi i rivlerësimit do të zhvillohet për këtë kategori funksionarësh, të cilët janë subjekte rivlerësimi, pavarësisht se nuk gëzojnë statusin e magjistratit.

11.3 Sipas parashikimeve të nenit 42, pikat 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë kriteret mbi të cilat kryhet procesi i rivlerësimit për këtë kategori në drejtim të vlerësimit e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit që gëzon këtë cilësi pa qenë magjistrat, duhet ndër të tjera t’i nënshtrohej edhe testimit në Shkollën e Magjistraturës, test i cili, referuar korrespondencës që ai ka pasur me Shkollën e Magjistraturës, nuk rezulton të jetë kryer nga subjekti Piro Samara, për shkak se sipas vlerësimit të tij, ai gëzonte statusin e magjistratit dhe nuk ishte e nevojshme t’i nënshtrohej këtij testi për vlerësimin e aftësive të tij profesionale, por duhej trajtuar nga organet e rivlerësimit dhe vetë Shkolla e Magjistraturës si me status magjistrat. Pavarësisht qëndrimit të subjektit në lidhje me pasjen ose mospasjen prej tij të statusit të magjistratit, kjo çështje konsiderohet e zgjidhur prej Kolegjit në referim të vendimit të KLGj-së që deklaroi mospasjen e këtij statusi, vendimi i cili nuk rezulton të ketë pasur asnjë kundërshti të ngritur prej subjektit në gjykatën kompetente, për pasojë konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

11.4 Në të njëjtën logjikë kushtetuese evidentohet edhe parashikimi i nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, në të cilin përcaktohet se [...] inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të drejtat dhe detyrimet që ka kjo kategori sipas parashikimeve të këtij ligji në varësi të vullnetit të çdo individi për të vazhduar një karrierë magjistrati apo për të ruajtur një pozicion me statusin e nëpunësit civil në administratën gjyqësore.

11.5 Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të padrejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Piro Samara nuk duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, pasi ai është deklaruar se nuk gëzon statusin e magjistratit dhe, në këto kushte, procedura administrative ka mbetur pa një objekt. Sipas vlerësimit të Kolegjit,

pavarësisht se subjekti nuk gëzonte këtë status sipas vendimmarrjes së KLGj-së, ai vazhdonte të ruante statusin e subjektit të rivlerësimit dhe Komisioni duhej të kishte verifikuar vullnetin e subjektit për të qëndruar ose jo në detyrën e inspektorit të KLGj-së në periudhën transitore, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë të cilit ai mund të transferohej në zbatim të nenit 165, pika 2⁴ e ligjit nr. 96/2016.

11.6 Për shkak të këtij arsyetimi, Kolegji vëren se trajtimi në rastin konkret i procedurës administrative si të mbetur pa objekt, sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, është irelevant dhe i pazbatueshëm. Situata faktike në të cilën gjendej subjekti i rivlerësimit, kondicionohej nga dy faktorë njëkohësisht, mospasja e statusit të magjistratit dhe pasja e statusit të subjektit të rivlerësimit, rrethanë e cila kërkonte një vlerësim specifik në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, si ligji i veçantë i zbatueshëm për situatën konkrete dhe, për më tepër, që parashikon një rregullim të posaçëm për situata të tilla. Në këto kushte, zbatimi i normës së përgjithshme, *lex generalis*, sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative, ndërkohë që ekziston parashikimi i posaçëm *lex specialis* sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe rregullimeve të ligjit nr. 84/2016, e bën të gabuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni, për sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm në rrethanat faktike konkrete. Në këtë kuadër, Komisioni duhej të verifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte shprehur vullnet për qëndrimin ose jo në detyrë për të identifikuar drejt normën e zbatueshme.

11.7 Në vijim të këtij arsyetimi dhe analize, Kolegji konstaton se Komisioni ka përdorur në vendimin e tij një argument tjetër mbi të cilin ka mbështetur vendimmarrjen, duke e përshkruar atë nëpërmjet përdorimit të bazës ligjore, konkretisht nenit 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016⁵. Sipas kësaj dispozite, është parashikuar mbarimi i statusit të magjistratit në rastet kur magjistrati mbush moshën 67 vjeç, por nga verifikimi i të dhënave identifikuese të subjektit të rivlerësimit, rezulton se ai ka lindur në vitin 1969⁶, duke e bërë të pamundur në këtë mënyrë aplikimin e kësaj dispozite për të konkluduar për përfundimin e statusit të magjistratit për shkak të moshës, edhe sikur subjekti të gëzonte këtë status. Në këto rrethana faktike, Kolegji konkludon se përdorimi i kësaj dispozite në vendimin e Komisionit është i gabuar si në referim të rrethanave faktike, ashtu dhe të dispozitës ligjore konkrete dhe, për më tepër, pa asnjë relevancë në zgjidhjen çështjes objekt gjykimi.

12. Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik se, duke qenë se subjekti i rivlerësimit Piro Samara, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të inspektorit në KLD, është subjekt rivlerësimi *ex officio*, dhe në rast të dorëheqjes nga ky funksion, duhej të gjente aplikim neni G i Aneksit të Kushtetutës, dhe se në këto kushte, Komisioni nuk ka identifikuar dhe vlerësuar drejt faktet dhe rrethanat ligjore mbi të cilat nuk duhej nisur/pushuar procesi i rivlerësimit duke

⁴ Pikat 1 dhe 2 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 parashikojnë:

“1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe **inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë**, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, **vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.**

⁵ Neni 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016 parashikon:

“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

[...] c)11 mbush moshën 67 vjeç [...]”.

⁶ Në vitin 2020, kur për subjektin e rivlerësimit Piro Samara, Komisioni ka dhënë vendimin nr. 249 objekt shqyrtimi, ai ishte ishte 51 vjeç.

mos aplikuar ndalimin e parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, duke e gjetur atë të drejtë.

12.1 Duke konsideruar se, pavarësisht nga fakti se është deklaruar mospasja e statusit të magjistratit për subjektin, ai gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit, Kolegji çmon se Komisioni duhej të kishte përcaktuar qartë rrethanat se përse procesi i rivlerësimit për këtë subjekt nuk duhej të niste në këndvështrim të drejtimit të rrethanave faktike dhe të bënte një përcaktim të saktë ligjor të kësaj situatë, e cila do të përcaktonte edhe mënyrën se si Komisioni do të dispononte për përfundimin apo ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si edhe për aplikimin ose jo të pikës së dytë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

12.2 Në këtë drejtim, në përgjigje edhe të pretendimit të ngritur në ankim prej Komisionierit Publik, Kolegji analizoi të dhënat që vijnë prej akteve të cilat gjenden në fashikullin e krijuar prej Komisionit dhe konstatoi se në të gjendej i administruar urdhri nr. {***}, datë 30.10.2019, i Kryetares së KLGj-së, nëpërmjet të cilit urdhërohet për “Lirimin nga detyra të z. Piro Samara, në detyrën e inspektorit së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit dhe kërkesës për dorëheqje”.

12.3 Kolegji konstaton gjithashtu se, në aktet e administruara në fashikull, nuk gjendej kërkesa e subjektit për dorëheqje nga detyra drejtuar KLGj-së dhe, për këtë arsye, në funksion të dhënies përgjigje të shkakut të ankimit i cili lidhej me verifikimin e vullnetit të subjektit të rivlerësimit në raport me marrëdhënien e tij të punës, prej gjyqtares relatores, në zbatim të përcaktimit të nenit 14, pika 5/ç e ligjit nr. 84/2016, u kërkua informacion shtesë nga KLGj-ja, nëpërmjet përcjelljes pranë Kolegjit të një kopjeje të aktit të dorëheqjes. Në përgjigje⁷ të kësaj kërkesë, KLGj-ja i ka përcjellë Kolegjit shkresën e titulluar “Kërkesë për dorëheqje”, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Piro Samara, drejtuar kryetares dhe sekretarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, tek e cila ai i shpreh se për arsye shëndetësore paraqet dorëheqjen e parevokueshme. Pasi Komisioneri Publik u njoh me përmbajtjen e kësaj kërkesë, ky akt u lejua të merret me cilësinë e provës nga Kolegji sipas vendimit të ndërmjetëm të marrë në seancë gjyqësore publike.

12.4 Bazuar në këtë informacion të marrë nga KLGj-ja, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit Piro Samara ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i tij si inspektor i KLD-së, veprim për të cilin Komisioni nuk ka kryer asnjë verifikim, edhe pse ka pasur të administruar urdhrin e kryetares së KLGj-së, që e referon dorëheqjen e subjektit si një prej arsye për të cilat është urdhëruar lirimi i tij nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës.

12.5 Në përmbledhje të situatës faktike, Kolegji evidenton se elementet që Komisioni duhet të kishte konsideruar për zgjidhjen e çështjes, duhej të ishin: (i) fakti se z. Piro Samara në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, në korrik 2016, ka ushtruar funksionin e inspektorit pranë KLGj-së, për pasojë, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, klasifikohet si subjekt rivlerësimi *ex officio*; (ii) fakti se nga të dhënat e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbushur moshën për pension dhe aplikimi i nenit 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016 është irelevant për zgjidhjen e çështjes; (iii) fakti se subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen nga detyra e inspektorit pranë KLGj-së, përgjatë kohës që ndaj tij kishte filluar procesi i rivlerësimit.

12.6 Kolegji konstaton se e gjithë kjo situatë faktike rezulton të mos jetë analizuar saktë nga Komisioni, i cili ka konkluduar në mënyrë të gabuar për procesin e rivlerësimit për z. Piro Samara, pa vendim përfundimtar, duke arsyetuar se për shkak të mbetjes pa

⁷ KLGj-ja kthen përgjigje me anë të shkresës së saj nr. {***}, datë 04.12.2020.

objekt, procesi i tij nuk duhej të niste ose duhej të pushonte, si edhe pa vendosjen e sanksionit të kërkuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Kolegji vlerëson se situata faktike e përshkruar më lart kondicionon ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Piro Samara, duke pasur si shkak ligjor dorëheqjen e tij nga detyra e inspektorit të KLGj-së.

12.7 Në këto rrethana, në zbatim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni duhej të kishte ndërprerë procesin e rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit nga detyra dhe jo të shprehej se procesi nuk duhet të nisë, aq më tepër kur nisja e procesit të rivlerësimit është një hap procedural, i cili ekziston për shkak të parashikimit ligjor të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që subjekti e ka fituar këtë cilësi për shkak të parashikimit kushtetues të nenit 179/b, dhe nuk mund të disponohet sipas një vendimmarrjeje të organeve të rivlerësimit. Organet e rivlerësimit, sipas parashikimeve ligjore, mundet që të rregullojnë situatat respektive të faktit dhe të ndërpresin, pushojnë, mbyllin pa një vendim përfundimtar apo të shprehen përfundimisht për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, por, në asnjë rast, nuk mund të disponojnë për mosnisen e këtij procesi, për sa kohë që ai ka nisur në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, nëse në këtë kohë subjekti i ka pasur funksionet e parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës. Në kushtet e zbatimit të kësaj dispozite, për shkak të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, gjen vend edhe zbatimi *ipso jure* i pikës së dytë të kësaj dispozite, e cila përcakton ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar si gjyqtar, prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokuror i Përgjithshëm apo Inspektor i Lartë i Drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare.

12.8 Gjithashtu, në funksion të pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me moszhvillimin e seancës dëgjimore nga Komisioni, Kolegji konstaton se nuk rezulton të ketë pasur asnjë komunikim midis Komisionit dhe subjektit për t'i bërë të ditur atij ecurinë e procesit të rivlerësimit, konkluzionet e Komisionit, vendimmarrjet e trupës apo ndonjë njoftim lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore publike, situatë e cila do të kishte prodhuar shkelje të rënda procedurale në drejtim të procesit për subjektin e rivlerësimit, por që nuk kanë relevancë në rastin konkret për shkak të faktit se: i) çështja ka si objekt shqyrtimin e ankimit të paraqitur prej Komisionerit Publik kundrejt vendimit të Komisionit; dhe se ii) në thelb, vendimi i ankimuar nuk duket se ka prodhuar ndonjë pasojë të disfavourshme apo penalizuese për subjektin e rivlerësimit, edhe sikur të ishte marrë në kushtet e shkeljeve procedurale.

12.9 Për më tepër, edhe nëse këto mangësi të procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioni do të kishin afektuar në çfarëdo mënyre të drejtat e subjektit, procesi gjyqësor në Kolegj u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në kuptim të nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti u thirr për t'u dëgjuar e mbrojtur verbalisht para gjykatës, çka do të shëronte edhe këto të meta në rast se subjekti do të kishte pretendime në raport me këto shkelje. Mungesa e subjektit në seancë gjyqësore dhe mosparaqitja e ndonjë pretendimi prej tij në lidhje me mënyrën në të cilën është zhvilluar procesi në Komision, shkarkon Kolegjin nga detyrimi i ndreqjes së këtyre shkeljeve apo korrektimit të tyre si qëllim në vetvete, pavarësisht se natyra publike e gjykimit i shëron ato *ipso lege* edhe në kushtet kur subjekti ka zgjedhur të mos paraqitet dhe të mos prezantojë prapësime qoftë për vendimin e Komisionit qoftë për shkaqet e ankimit.

- 13.** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, gjatë të cilit u dëgjuan pretendimet dhe qëndrimi i Komisionerit Publik dhe u verifikua vullneti i subjektit të rivlerësimit për t'u dorëhequr nga detyra e Inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet aktit të përcjellë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me shkresën me nr. {***} prot., datë 04.12.2020, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi e bisedoi çështjen dhe vlerësoi të gjitha

shkaqet e ankimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe në legjislacionin e zbatueshëm, Kolegji arriti në përfundimin se procesi i rivlerësimit për subjektin Piro Samara duhej ndërprerë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për shkak të dorëheqjes së tij, e cila ka prodhuar si pasojë edhe nxjerrjen e urdhrit nr. {***}, datë 30.12.2019, të kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor për lirim të tij nga detyra.

14. Në vijim të këtij konkluzioni, Kolegji çmon përfundimisht se ndërprerja e procesit të rivlerësimit duhet të shoqërohet sipas ligjit edhe me aplikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
15. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 249, datë 06.03.2020, është marrë duke vlerësuar në mënyrë të gabuar rrethanat e faktit dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 249, datë 06.03.2020, si më poshtë.

1. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar që i përket subjektit të rivlerësimit Piro Samara, me detyrë inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.01.2021

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi